



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.04.2023

MBLEDHJA Nr. 21,
Datë 14.04.2023, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 14.04.2023, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 21 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 11.04.2023
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “Teodori” sh.p.k. për transferimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Ternovë Zall Bulqizë” sh.p.k.
4. Mbi miratimin e Kufirit Minimal dhe Maksimal të lejuar të çmimit për tregun e Ditës në Avancë, për të cilin ALPEX i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të dytë, sipas përcaktimeve të Procedurës së Tregtimit
5. Mbi miratimin e raportit për implementimin e sistemit rajonal të Komunitetit të Energjisë të garancive të origjinës

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI